



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË**  
**DHËNAVE PERSONALE**  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA E HETIMIT SEKTORIAL DHE SIGURISË SË TË DHËNAVE

Nr. 1390/7 prot.

Tiranë, më 30.07.2025

**REKOMANDIM**

**Nr. 44, datë 30.07.2025**

**PËR KONTROLLUESIN “ UNIVERSITETI EUROPIAN I TIRANËS ”**

Në mbështetje të neneve 81, 82, 83 dhe 84 të ligjit nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, (në vijim, “Ligji”), neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (në vijim, “Kodi i Procedurave Administrative”), procesverbalit të hetimit administrativ dhe provave të administruara në ngarkim të “Universitetit European i Tiranës”, Tiranë (në vijim, “Kontrolluesi”),

**KONSTATOVA SE:**

Në zbatim të Urdhrit nr. 101, datë 14.05.2025 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “Komisioneri”), u krye hetimi administrativ pranë Kontrolluesit me objekt:

- *Zbatim i ligjit nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, dhe akteve të miratuara nga Komisioneri në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit nga Kontrolluesi.*

Komisioneri, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë Kontrolluesit, vëren se:

1. Universiteti European i Tiranës, ushtron veprimtarinë si shkollë e lartë universitare, jopublike, bazuar në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” si dhe VKM nr. 636, datë 20.09.2006 “Për dhënien e lejes për hapjen e shkollës së lartë universitare, jopublike “Universiteti European i Tiranës”.

Kontrolluesi në kuadër të veprimtarisë që ushtron, përpunon të dhëna personale për kategoritë “studentë”; “staf akademik”; “staf administrativ”, etj. Përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë manuale dhe elektronike.

2. Konstatohet se, në dosjet e personelit të larguar ruhen, ndër të tjera, kopje të dokumentacionit si: “Vërtetim i gjendjes gjyqësore”; “Raport i aftësisë në punë”; “Librezë shëndeti”; “Të dhënat e llogarisë bankare”; “Librezë pune”; “Kopje e mjetit të identifikimit” etj.,.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion nga Kontrolluesi, “Rregullore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, konstatohet se, Kontrolluesi nuk ka parashikuar afate konkrete lidhur me kohën e ruajtjes së të dhënave personale, për dokumentacionin që administrojnë në funksion të veprimtarisë që ushtron, në kundërshtim me pikën 5, të nenit 6 të Ligjit, si dhe me Udhëzimin nr. 11, datë 08.09.2011 të Komisionerit “Mbi përpunimin e të dhënave të punonjësve në sektorin privat” i ndryshuar (në vijim, “Udhëzimi nr. 11”).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, lidhur me të dhënat personale të grumbulluara (të personelit të larguar), Kontrolluesi duhet të parashikojë ruajtjen e të dhënave personale në atë formë, që lejon identifikimin për një kohë të caktuar, por jo më tepër se sa është e nevojshme për të përmbushur qëllimin e grumbullimit. Koha e ruajtjes së të dhënave personale duhet të përcaktohet nga Kontrolluesi, në përputhje me parashikimet ligjore specifike dhe qëllimin e grumbullimit të informacionit.

3. Kontrolluesi, disponon llogari në rrjetet sociale “Facebook” dhe “Instagram”, në të cilat pasqyron aktivitetet që zhvillon, duke i publikuar përmes fotografive dhe videove të studentëve, stafit akademik etj, të marra gjatë aktiviteteve edukative, kulturore, festa, etj.

Konstatohet se Kontrolluesi nuk aplikon marrjen e pëlqimit ndaj subjekteve të të dhënave, për publikimin e pamjeve fotografike dhe filmike në rrjetet sociale që administrojnë, në kundërshtim me parimet e mbrojtjes së të dhënave personale dhe kriteret ligjore për përpunimin e të dhënave, të parashikuara në nenet 6 dhe 7 të Ligjit, si dhe Udhëzimit nr. 1, datë 30.04.2025 të Komisionerit “Për masat e sigurisë së të dhënave personale në fushën e arsimit”, (në vijim, “Udhëzimi nr. 1”).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, përpunimi i të dhënave personale të subjekteve të të dhënave, përmes publikimit të fotografive të subjekteve të të dhënave në platformat “Facebook” dhe “Instagram” në rastin konkret, pa marrë paraprakisht “Pëlqimin”, bie në kundërshtim me nenet 6 dhe 7 të Ligjit dhe Udhëzimin nr. 1.

“Pëlqim” është çdo element tregues i vullnetit të subjektit të të dhënave, i dhënë lirisht, i informuar dhe i qartë, nëpërmjet të cilit ai, me anë të një deklarate ose me çdo lloj shfaqjeje tjetër të padyshimtë pohuese të vullnetit, shpreh dakordësinë për përpunimin e të dhënave personale, që lidhen me të për një ose më shumë qëllime specifike.

4. Kontrolluesi ka të instaluar një sistem video-survejsimi CCTV, për mbikëqyrjen e ambienteve të brendshme dhe të jashtme ku ushtron veprimtarinë. Konstatohet se, kamerat janë pozicionuar në ambientet e brendshme të auditoreve ku zhvillohet mësimi, në kundërshtim me parashikimet e neneve 6 dhe 7 të Ligjit.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion grupit të hetimit, rregullore “Për regjistrim dhe administrimin e të dhënave të sistemit të kamerave të instaluar në UET”, konstatohet se, lidhur me këtë proces përpunues, Kontrolluesi referuar nenit 8 të Rregullores “Administrimi i materialit të regjistruar” ka parashikuar afate për ruajtjen e imazheve të sistem video-survejsimi CCTV maksimumi për 30 ditë, por nga verifikimi në vend konstatohet se ato ruhen për një periudhë më të gjatë se 60 ditë, në kundërshtim me parimin e ruajtjes në kohë, sipas pikës 5, të nenit 6 të Ligjit dhe të nenit 3 “Afati i ruajtjes”, të Udhëzimit nr. 3, datë 30.04.2025 të Komisionerit “Për përpunimin e të dhënave personale nga sistemet e video-survejsimit”, (në vijim, “Udhëzimi nr. 3”).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, një nga mjetet e rëndësishme të përpunimit të të dhënave personale është edhe sistemi i video survejsimit CCTV. Të dhënat e ruajtura në këto sisteme, si: “imazhe” e “video”, janë të dhëna personale dhe përpunimi i tyre duhet të jetë në përputhje me parashikimet e Ligjit, si dhe aktet e miratuara nga Komisioneri në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit nga Kontrolluesi.

Gjithashtu, Zyra e Komisionerit vlerëson se periudha e mbajtjes së të dhënave nuk duhet të kalojë kufirin maksimal të afatit të lejuar, për përmbushjen e qëllimit të video survejsimit. Të dhënat e mbajtura me anë të sistemit të video survejsimit duhet të ruhen për një periudhë deri në dy muaj, dhe në momentin që qëllimi ka përfunduar duhet të realizojë shkatërrimin e të dhënave imazheve/video, në të kundërt përpunimi i mëtejshëm i të dhënave konsiderohet i paligjshëm, sipas parashikimeve të pikës 5, të nenit 6 të Ligjit dhe të Udhëzimit nr. 3 të Komisionerit.

5. Konstatohet se, Kontrolluesi nuk ka të publikuar rubrikën “Politikat e Privatësisë” në faqen zyrtare të internetit [www.uet.edu.al](http://www.uet.edu.al). Subjektet e të dhënave nuk informohen mbi qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, personin që do t’i përpunojë të dhënat, afatin e mbajtjes së të dhënave, masat e sigurisë, të drejtat që subjektet e të dhënave gëzojnë (për akses, korrigjim dhe fshirje), etj., në kundërshtim me parashikimet e nenit 13 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, çdo kontrollues që përpunon të dhëna personale pavarësisht faktit nëse përpunimi bëhet në mënyrë elektronike apo manuale, dhe pavarësisht faktit nëse mbledh apo jo të dhëna personale nëpërmjet faqes zyrtare të internetit, ka detyrim që të publikojë “*Politikën e Privatësisë*”, dhe të informojë qartësisht subjektet e të dhënave, pasi kontakti paraprak i çdo subjekti të dhënash me kontrolluesin realizohet nëpërmjet faqes së internetit.

6. Kontrolluesi ka vendosur në dispozicion të grupit të hetimit “*Rregullore për mbrojtjen përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*”, por nga shqyrtimi i përmbajtjes së saj rezulton se, rregullorja i referohet modelit “tip” të publikuar në faqen zyrtare të Zyrës së Komisionerit.

Rezulton se, përmbajta e rregullores është e kufizuar dhe nuk reflekton detyrimet ligjore, sipas kategorive specifike të të dhënave personale që përpunon Kontrolluesi, nuk parashikon proceset, procedurat, masat teknike dhe organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, sigurinë e të dhënave, afatet e mbajtjes së të dhënave, etj., në kundërshtim me parashikimet e nenit 28 të Ligjit, me qëllim garantimin e përpunimit të ligjshëm dhe sigurisë së të dhënave, në përputhje me proceset përpunuese të Kontrolluesit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, është i nevojshëm rishikimi i këtij akti, ku të parashikohen rregulla dhe procedura organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, sipas proceseve përpunuese gjatë kryerjes së aktivitetit nga Kontrolluesi, në përputhje me parashikimet e nenit 28 të Ligjit.

7. Kontrolluesi nuk ka ndërmarrë masa konkrete në kuadër të trajnimit të punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale, lidhur me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Grupi i kontrollit konstaton mosplotësim i detyrimeve në lidhje me ngritjen, administrimin dhe mirëmbajtjen e Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit (SMIS), për sa i takon mbrojtjes së të dhënave personale, të parashikuar në Udhëzimin nr. 47 të Komisionerit, datë 14.09.2018 “*Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha*”, (në vijim, “*Udhëzimi nr. 47*”), si dhe në zbatim të nenit 28 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, Kontrolluesi duhet të marrë masa konkrete në kuadër të trajnimit të punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale, bazuar në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale si dhe në zbatim të Udhëzimit nr. 47 të Komisionerit.

Gjithashtu, Zyra e Komisionerit vlerëson se, për shkak të cilësisë si subjekt përpunues i madh, si dhe për shkak të natyrës së veprimtarisë që ushtron, e cila kërkon masa të shtuara teknike dhe organizative për garantimin e sigurisë së të

dhënave personale, Kontrolluesi, është i detyruar të krijojë, mirëmbajë dhe administrojë SMSI në përputhje me parashikimet e Udhëzimit nr. 47.

SMSI për mbrojtjen e të dhënave personale duhet të bazohet në standardin ISO/IEC 27001, siç parashikohet në nenin 5 të Udhëzimit nr. 48, datë 14.09.2018, të Komisionerit *“Për certifikimin e sistemeve të sigurisë së informacionit, të dhënave personale dhe mbrojtjes së tyre”* (në vijim, “Udhëzimit nr. 48”) si dhe është një sistem i certifikueshëm, për qëllime përputhshmërie me standardin e sipërpërmendur, vetëm me organizma të akredituar dhe autorizuar sipas parashikimeve të Udhëzimit nr. 48.

8. Konstatohet se, aktivitetet kryesore të kontrolluesit janë procese përpunimi, të cilat, për shkak të natyrës, fushës së zbatimit ose qëllimeve të tyre, kërkojnë monitorim të rregullt e sistematik të subjekteve të të dhënave në një shkallë të gjerë. Megjithatë, Kontrolluesi nuk ka emëruar një nëpunës të mbrojtjes së të dhënave personale, në kundërshtim me nenin 33 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, caktimi i një nëpunësi për mbrojtjen e të dhënave personale, është një detyrim i rëndësishëm që ka për qëllim garantimin e sigurisë së të dhënave personale gjatë proceseve përpunuese që realizohen nga ana e Kontrolluesit gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij.

Gjithashtu, bazuar në pikën 3, të nenit 34 të Ligjit, Kontrolluesi ka detyrimin për të njoftuar Zyrën e Komisionerit në rastin e caktimit të një nëpunësi të mbrojtjes së të dhënave, në mënyrë që subjektet e të dhënave të mund ta kontaktojnë atë, për të gjitha çështjet që lidhen me përpunimin e të dhënave të tyre personale dhe ushtrimin e të drejtave të tyre, sipas këtij Ligji.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i inspektimit hartoi procesverbalin përkatës, një kopje e të cilit i është vendosur në dispozicion Kontrolluesit nëpërmjet rrugës postare.

Në respektim të së drejtës për t’u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave Administrative, Kontrolluesi është ftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit.

Përfaqësuesi i Kontrolluesit, gjatë seancës dëgjimore të zhvilluar në datë 09.7.2025, ka shprehur dakordësinë lidhur me konstatimet e grupit të hetimit dhe ka deklaruar angazhimin për rikuperimin e shkeljeve të konstatuara gjatë hetimit administrativ, si dhe ka vendosur në dispozicion dokumente si më poshtë vijon:

- Rregullore për Mbrojtjen, Ruajtjen dhe Sigurinë e të Dhënave Personale në Universitetin European të Tiranës;

- Vendim nr. 8672/1 prot., datë 09.11.2017 “Vendim i Komisionit të Vlerësimit të Masave Shtesë të Sigurisë”;
- Urdhër i administratorit të UET, nr. 357 prot., datë 16.06.2025 “Për garantimin e sigurisë së të dhënave sensitive dhe emërimin në detyrë të nëpunësit të mbrojtjes së të dhënave personale”;
- Rregullore “Për regjistrimin dhe administrimin e të dhënave të sistemit të kamerave të instaluar në UET”;
- Politikat e Privatësisë;
- Listëprezencë, nëpërmjet të cilës jepet pëlqimi për publikimin e imazheve në rrjetet sociale të UET;
- Kontratë tip individuale pune;
- Tabela e detyrimeve sipas pozicioneve në UET;
- Model tip “Deklaratë Konfidencialiteti”;
- Kontratë shërbimi ndërmjet studentit dhe UET.

Në përfundim, Zyra e Komisionerit vlerëson bashkëpunimin e Kontrolluesit me grupin e kontrollit, gjatë ushtrimit të hetimit administrativ, si dhe angazhimin e tij për të rikuperuar shkeljet e konstatuara. Plotësimi i këtyre detyrimeve nga ana e Kontrolluesit është mjaft i rëndësishëm pasi garanton përpunimin e ligjshëm, sigurinë e të dhënave personale dhe shmang mundësinë e përhapjes së tyre në mënyrë të paligjshme.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Në zbatim të neneve 6, 7, 13, 28, 33, 34, 81, 82, 83 dhe 84 të Ligjit

#### **REKOMANDOJ:**

1. Kontrolluesi, të ketë në vëmendje përpunimin e të dhënave personale, si dhe të marrë masa për përcaktimin e afateve kohore për ruajtjen e të dhënave, në përputhje me pikën 5, të nenit 6 të Ligjit. Në momentin e përfundimit të qëllimit të përpunimit, Kontrolluesi duhet të realizojë shkatërrimin e këtyre të dhënave, pasi përpunimi i mëtejshëm i tyre konsiderohet i paligjshëm;
2. Kontrolluesi, të ketë në vëmendje marrjen e “Pëlqimit” të subjekteve të të dhënave në përputhje me parimet dhe kriteret ligjore të sanksionuara në nenet 6 dhe 7 të Ligji;
3. Kontrolluesi të ndalojë menjëherë përpunimin e mëtejshëm të të dhënave personale përmes sistemit të survejimit CCTV në ambientet e punës së punonjësve, si dhe të shkatërrojë në mënyrë të parikuperueshme të dhënat “video/audio” të mbledhura për subjektet e të dhënave “punonjës”, të cilat janë përpunuar, në kundërshtim me dispozitat e neneve 6 dhe 7 të Ligjit. Në këtë kuadër të mbajë evidenca për shkatërrimin;

4. Kontrolluesi, të marrë masa për publikimin e “*Politikave të Privatësisë*” në faqen e internetit, në lidhje me informimin e subjekteve të të dhënave, sipas parashikimeve të nenit 13 të Ligjit;
5. Kontrolluesi, në zbatim të nenit 28 të Ligjit, të përfshijë në rregulloren “*Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*”, masa konkrete teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave personale, për çdo kategori të dhënash që përpunon dhe për çdo proces përpunimi, mënyrat e përpunimit të të dhënave, të drejtat e subjekteve të të dhënave, etj.;
6. Kontrolluesi, të marrë masa për caktimin e nëpunësit për mbrojtjen e të dhënave personale, sipas parashikimeve të neneve 33 dhe 34 të Ligjit, si dhe të njoftojë Zyrën e Komisionerit për caktimin e tij;
7. Kontrolluesi, me qëllim garantimin e sigurisë së të dhënave personale duhet të zbatojë detyrimet e përcaktuara në Udhëzimin nr. 47, lidhur me trajnimin e punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale si dhe krijimin, mirëmbajtjen dhe administrimin e Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit (SMSI) për mbrojtjen e të dhënave personale;
8. Kontrolluesi, për shkak të natyrës së veçantë të aktivitetit që ushtron, duhet të marrë masat e nevojshme për të vlerësuar mbi certifikimin e sistemeve të menaxhimit të sigurisë së informacionit, të të dhënave personale dhe mbrojtjes së tyre, sipas parashikimeve të Udhëzimit nr. 48;
9. Në zbatim të nenit 84 të Ligjit, të përmbushen detyrimet, sipas këtij akti brenda afateve, si vijon:
  - (i) menjëherë, detyrimet e përcaktuara në pikën 3 më sipër;
  - (ii) vazhdimisht, detyrimet e treguara në pikën 2 më sipër;
  - (iii) brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, detyrimet e përcaktuara në pikat 1 dhe 4 më sipër;
  - (iv) brenda 30 (tridhjetë) ditëve, detyrimin e përcaktuar në pikat 5 dhe 6 më sipër;
  - (v) brenda 45 (dyzetë e pesë) ditëve, detyrimet e përcaktuara në pikën 7 më sipër;Afatet e sipërpërmendura fillojnë nga data e marrjes dijeni të këtij akti;
10. Kontrolluesi të njoftojë Komisionerin për masat e marra;
11. Në rast mospërmbushje të detyrimeve të parashikuara në këtë akt, Komisioneri, bazuar në gurmën “a”, pika 2, e nenit 83 të Ligjit, paralajmëron kontrolluesit ose përpunuesit se veprimet e përpunimit mund të rezultojnë në mosplotësim të dispozitave ligjore dhe u jep atyre rekomandime lidhur me përputhshmërinë me ligjin. Në rast shkeljesh serioze ose të qëllimshme të dispozitave ligjore, Komisioneri vepron sipas neneve 92, 93 dhe 94 të Ligjit, për vendosjen e sanksioneve administrative në

përputhje me nenet përkatëse, si dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet administrative, në mënyrë të tillë që këto masa të jenë efektive, proporcionale dhe me karakter parandalues.

Ky Rekomandim u shpall sot, më 30.07.2025.

**KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**